



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KRYETARI

Nr. 284 prot.

Korçë më, 14/01/2019

URDHËR

Nr. 16, datë 14/01/2019

Mbi subjektet që do të liçencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Korçë

Pas shqyrtimit dhe miratimit të relacionit të paraqitur nga Komisioni Vlerësues në transportin e udhëtarëve në linja të rregullta rrethqytetëse, të datës 10.01.2019, bazuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 64, pika a; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar, neni 11, pika 7/a;

URDHËROJ:

1. Subjekti fitues në konkursin e zhvilluar prej 20.12.2018-04.01.2019, "Për përzgjedhjen e subjektit / subjekteve, që do të liçencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Korçë", në të cilat nuk ka operator të liçencuar, do të jetë subjekti "Andrea Bala", me NUIS L54703008J, me autobusin me targë AA160OR, në linjën Vinçan-Korçë-Vinçan.
2. Të vijohet më tej me procedurën e liçencimit për këtë subjekt, në linjën Vinçan-Korçë-Vinçan.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi

N. Lika

Drejtoria e Përgjithshme

Juridike

A. Dishnica

